



# EASO - Raporti rreth Azilit, 2020

Raporti Vjetor rreth  
situatës së azilit në  
Bashkimin Evropian

**Përmbledhje e përgjithshme**



# **EASO - Raporti rreth azilit, 2020**

**Raporti Vjetor rreth situatës së azilit në Bashkimin Evropian**

**PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

SUPPORT IS OUR MISSION

Imazhi i kopertinës: Fotografia e OKB-së/Eskinder Debebe  
Ikonat dhe ilustrimet: iStock nga Getty Images, Microsoft 365

© Zyra Mbështetëse Evropiane për Azilin, 2020  
Riprodhimi autorizohet me kusht që të bëhet i ditur burimi.

Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat të drejtat e autorit nuk i ka EASO, duhet të kërkohet leje direkt nga zotëruesi i të drejtave të autorit.

ISBN 978-92-9485-543-5

DOI 10.2847/458142

Numri i katalogut BZ-04-20-293-SQ-N



## Parathënie

Ndërkohë që Evropa përsëri po përjeton një rritje në numrin e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare në vitin 2019 (për herë të parë që prej vitit 2015), azili mbetet një prioritet i lartë në axhendën e politikës së BE-së. Me ndryshimin e tendencave me kalimin e kohës, ne kolektivisht vazhdojmë të punojmë drejt ofrimit të zgjidhjeve optimale për personat që kanë nevojë për mbrojtje, ndërkohë që ruajmë integritetin e sistemeve kombëtare të azilit.

Edicioni i vitit 2020 i *EASO - Raporti rreth Azilit* ofron një përmbledhje koncize dhe gjithëpërfshirëse të zhvillimeve kyç në mbrojtjen ndërkombëtare dhe në funksionimin e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Për të hartuar raportin e vet vjetor, EASO grumbullon dhe analizon informacione nga një gamë e gjerë burimesh të besueshme për të dhënë një pamje më në thellësi të ndryshimeve të politikës dhe përmirësimeve gjatë vitit, ndërsa thekson sfidat që mbeten për t'u adresuar.



Ndërsa EASO feston 10-vjetorin e vet në vitin 2020, ne kujtojmë rëndësinë në rritje të agjencisë në ofrimin e asistencës teknike në çështjet e azilit në vendet BE+. Informacioni i prodhuar nga EASO është jetësor për t'u dhënë mundësinë ligjvënësve për të bërë ndryshime të informuara, për të ndihmuar që vendet të përballen me tablonë gjithnjë e më në ndryshim të motiveve të migrimit dhe për të fuqizuar administratat kombëtare në përpunimin, rast pas rasti, e një rrjedhe të vazhdueshme aplikimesh.

Ne presim me padurim miratimin e pritur prej kohësh të një rregulloreje të re për Agjencinë e Azilit të Bashkimit Evropian, që do ta transformojë EASO-n në një agjenci të plotë të BE-së, do të forcojë rolin e saj dhe do të zgjerojë mandatin e saj. Si qendra e ekspertizës mbi azilin, EASO-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje të paanshme, transparente dhe të orientuar drejt shërbimit, drejt implementimit efektiv të CEAS-së.

Jam mirënjohëse për bashkëpunimin e vazhdueshëm me të gjithë partnerët tanë drejt sistemeve të përbashkëta, transparente dhe të qëndrueshme të azilit në mbarë Evropën. Sistemet efikase mund të reagojnë me shpejtësi ndaj motiveve në ndryshim në flukset e migrimit dhe të sigurojnë një proces të drejtë dhe dinjitoz për secilin aplikues për mbrojtje ndërkombëtare. Në vitin 2020 jemi duke parë tashmë situata globale dhe kombëtare që mund të sjellin në më shumë njerëz që kërkojnë strehim. Tani, më shumë se asnjëherë, duhet të vazhdojmë të punojmë drejt një sistemi vërtet të përbashkët evropian të azilit duke arritur konvergencë në adresimin e nevojave për mbrojtje ndërkombëtare dhe duke u shfaqur solidaritet Shteteve Anëtare që janë nën presionin më të madh.

**Nina Gregori**

Drejtoreshë Ekzekutive  
Zyra Mbështetëse Evropiane për Azilin

## Hyrje

[EASO - Raporti rreth Azilit, 2020](#) ofron një përmbledhje gjithëpërfshirëse të zhvillimeve në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare në nivele evropiane dhe kombëtare. Bazuar në një gamë të gjerë burimesh, raporti paraqet një përmbledhje të shkurtër të kontekstit global të azilit, thekson zhvillimet në Bashkimin Evropian (BE) dhe ekzaminon tendencat dhe ndryshimet kryesore në legjislacion, politika, praktika dhe ligjin e praktikës nëpër Shtetet Anëtare të BE-së, Islandë, Lihtenshtajn, Norvegji dhe Zvicër (Vendet BE+). Raporti fokusohet në fushat kryesore të Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS), ndërsa merr në konsideratë kontekstin më të gjerë të migrimit dhe të të drejtave themelore.



## 1. Përmbledhje globale e fushës së azilit në vitin 2019



Shtetasit nga Siria përbënin një të tretën e popullatës globale të refugjatëve, me 6,6 milionë që janë larguar nga vendi i tyre.

Zhvendosjet e detyruara për shkak të konfliktit, përndjekjes, shkeljes së të drejtave të njeriut, katastrofave natyrore dhe degradimit të ekosistemeve janë një realitet për miliona veta në mbarë globin që largohen nga shtëpitë e tyre në kërkim të sigurisë. Gjatë viteve të fundit, zhvendosjet masive të popullatave u shkaktuan nga konfliktet, dhuna ekstreme dhe destabilizimi i thellë politik në rajone të ndryshme të botës.

Mes personave të prekur nga zhvendosjet, një “refugjat” sipas përkufizimit është një person që është detyruar të largohet nga vendi i tij/saj për shkak të frikës së bazuar nga përndjekja për arsye të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike. “Personat e zhvendosur brenda vendit” nuk e kanë kaluar kufirin e vendit të tyre, por sërish mund të gjenden në një situatë delikate.

Në kontekstin e Evropës, mbrojtja ndërkombëtare përfshin statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes së përkohshme. Kjo e fundit u referohet personave të cilët nuk kualifikohen për statusin e refugjatit, por kanë të drejtën e mbrojtjes për shkak se rrezikohen nga dëmtimi i rëndë, ku përfshihet dënimi me vdekje ose ekzekutimi; tortura ose trajtimi apo ndëshkimi çnjerëzor ose poshtëruar në vendin e origjinës; ose kërcënimi i rëndë dhe individual për jetën për shkak të dhunës së verbër në situatat e konfliktit të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm.

Në qershor të vitit 2019, Komisari i Lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara (UNHCR) raportoi një popullatë që përbën shqetësim në një numër total prej 79,4 milionë njerëzish, duke përfshirë 20,2 milionë refugjatë, 3,7 milionë azilkërkues, 531 000 refugjatë të kthyer, 43,9 milionë persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV), 2,3 milionë PZHBV të kthyer dhe 3,9 milionë persona pa nënshtetësi sipas mandatit të UNHCR.

6,6 milionë refugjatët nga Siria përbënin rreth një të tretën e popullatës globale të refugjatëve, ndjekur nga Afganistani dhe Sudani i Jugut, me 2,7 milionë dhe 2,2 milionë përkatësisht. Për ata që kërkonin mbrojtje, grupi më i madh i azilkërkuesve në vitin 2019 ishin shtetas të Venezuelës.

Vendet fqinje me epiqendrën e një krize shpesh janë të parët në radhë për të pritur personat e zhvendosur. Në vitin 2019, në terma absolutë, Turqia priti numrin më të madh të refugjatëve, e ndjekur nga Pakistani, Uganda, Gjermania dhe Sudani. Në terma relativë, Libani, Jordania dhe Turqia pritën pjesën më të madhe të refugjatëve krahasuar me numrin e popullatës së tyre.

Ndërsa numri i personave të zhvendosur vazhdon të rritet globalisht, qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile po zhvillojnë strategji për t’iu përgjigjur sfidave komplekse që paraqet zhvendosja e detyruar. Forumi i Parë Global mbi Refugjatët u zhvillua në dhjetor të vitit 2019 për të monitoruar zhvillimet dhe për të rishikuar progresin rreth planit të masave të përcaktuar sipas Kompaktit Global për Refugjatët të vitit 2018. Kompakti u adresohet, mes të tjerash, përgjegjësisë së përbashkët, pritjes së refugjatëve dhe mbështetjes së komuniteteve pritëse në një mënyrë të qëndrueshme.


Nisma të reja vazhdojnë të shfaqen globalisht, duke lejuar që fusha të ndryshme të migrimit të detyruar të kalojnë në plan të parë dhe të adresohen brenda audiencave më të gjera. Dy tema që tërhoqën më shumë vëmendjen gjatë vitit 2019 janë mungesa e nënshtetësisë dhe lëvizshmëria për shkak të arsyeve klimatike dhe mjedisore.


Një aspekt shpesh i anashkaluar i migrimit të detyruar, mungesa e nënshtetësisë ka fituar më shumë vëmendje gjatë vitit 2019 ndërsa objektivi i çështjes u bë edhe më i qartë. Në tetor të vitit 2019, një Segment Ndërkombëtar i Nivelit të Lartë mbi Mungesën e Nënshtetësisë shënoi mesin e fushatës #IBelong, një nismë e prezantuar nga UNHCR në vitin 2014 për t'i dhënë fund mungesës së nënshtetësisë deri në vitin 2024. Ngjarja vlerësoi arritjet e bëra deri më sot në lidhje me 10 objektivat e [Planit Global të Veprimit për t'i Dhënë Fund Mungesës së Nënshtetësisë](#).

Megjithëse ndikimi i katastrofave klimatike rreth zhvendosjeve të popullatës nuk është fenomen i ri, ai po fiton një vend edhe më të rëndësishëm në diskutimet humanitare, legjislative dhe të politikave që rrethon zhvendosjen. Njohja në rritje e ndikimit të faktorëve mjedisorë në lëvizshmërinë e njerëzve ka nxitur diskutime rreth politikave, si në nivele rajonale, ashtu edhe globale, për ta adresuar ndikimin e tyre.



## Pjesa e refugjatëve dhe vendet pritëse në nivel global, 2019



 #EASOAsylumReport2020  
[www.easo.europa.eu/asylum-report-2020](http://www.easo.europa.eu/asylum-report-2020)  
 Burimi: EASO dhe UNHCR

## 2. Zhvillimet në Bashkimin Evropian



Në vitin 2019 nuk u vërejt asnjë progres madhor legjislativ në lidhje me miratimin e paketës së reformave të CEAS. Në dritën e zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, negociatat për paketën e reformave iu referuan sesionit të ardhshëm parlamentar. Por, është bërë progres në fushat e legjislativit që lidhen direkt me azilin. Në maj të vitit 2019, Këshilli i Evropës miratoi dy rregullore që përcaktojnë një kuadër për ndërfunksionimin e sistemeve të informacionit të BE-së në fushat e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme. Gjithashtu, në qershor të vitit 2019, Këshilli miratoi pozicionin e pjesshëm të përbashkët mbi Direktivën e Kthimit, të ndryshuar, e cila u propozua nga Komisioni Evropian në shtator të vitit 2018.

Tema e azilit mbeti në krye të axhendës politike të BE-së në vitin 2019. Në pritje të negociatave legjislative, u krye një punë e konsiderueshme në implementimin e politikave dhe bashkëpunimin praktik mes vendeve BE+. Axhenda Strategjike e BE-së për vitet 2019-2024, e cila është miratuar nga Këshilli i Evropës në qershor të vitit 2019, përcaktoi prioritetet kryesore për ciklin e ardhshëm institucional, duke përfshirë migracionin dhe azilin si fusha prioritare me një fokus mbi menaxhimin e kufijve sipas vlerave të BE-së; bashkëpunimin me vendet e origjinës dhe të tranzitit, si edhe një konsensus shumë të nevojshëm mbi reformën e sistemit të Dublinit për të arritur balancën e përgjegjësisë dhe solidaritetit.

Në janar të vitit 2020, Komisioni Evropian publikoi programin e vet të ri të punës, duke pasur si një prej prioritetëve të veta prezantimin e një pakti të ri që do të njohë ndërlidhjen e aspekteve të brendshme dhe të jashtme të migracionit dhe do të përpiqet për sisteme azili dhe migracioni më efektive dhe më humane.

Në tetor 2019, Komisioni Evropian publikoi një [Progres-Raport mbi Implementimin e Axhendës Evropiane mbi Migracionin](#) që rishikoi arritjet kryesore që prej vitit 2015 dhe u fokusua te zhvillimet në vitin 2019. Ndërkohë që hapi i reformave legjislative ka qenë gradual, progresi ka qenë më i shpejtë në implementimin e politikave dhe konsolidimin e paketës së mjeteve të BE-së për menaxhimin efektiv të migracionit dhe azilit, duke përfshirë mbështetjen e shpejtë operationale dhe financiare për Shtetet Anëtare që përjetojnë trysni në rritje.

Me gjithë uljen e përgjithshme në numrin e mbërritjeve në kufijtë e jashtëm të BE-së gjatë vitit 2019, u shfaqën tendenca të ndryshme në itineraret e migracionit drejt BE-së. Itineraret e Mesdheut Perëndimor dhe Qendror kishin më pak mbërritje krahasuar me vitin 2018, ndërsa itineraret e Mesdheut Lindor dhe Ballkanit Perëndimor patën rritje të mbërritjeve.

Një dimension kyç i përfaqësues së BE-së për ta adresuar itinerarin e Mesdheut Lindor është partneriteti me Turqinë nëpërmjet [Deklaratës BE-Turqi](#). Si rezultat i deklaratës, pas katër vitesh implementimi, mbërritjet e emigrantëve të parregullt nga Turqia drejt BE-së mbetën 94% më të ulëta se përpara marrëveshjes, dhe një total prej rreth 27 000 refugjatësh sirianë janë rivendosur nga

Këshilli i Evropës miratoi Axhendën Strategjike të BE-së për vitet 2019-2024, me azilin si një fushë prioritare





Turqia drejt një vendi BE+. Për periudhën 2016-2025, është caktuar një total prej 6 miliardë eurosh nëpërmjet Instrumentit për Refugjatët për të mbështetur refugjatët dhe komunitetet pritëse në Turqi, duke u fokusuar në ndihmën humanitare, arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën komunale dhe mbështetjen social-ekonomike. Një fushë në të cilën nevojitet më shumë progres është implementimi i kthimeve nga ishujt grekë drejt Turqisë.

Zbarkimi i migrantëve të shpëtuar në Detin Mesdhe vazhdoi edhe në vitin 2019, duke theksuar nevojën për një përjasje më sistematike dhe më të koordinuar nga BE-ja ndaj zbarkimeve duke përfshirë pritjen e parë, regjistrimin dhe rivendosjen. Një Takim Ministror mbi Migrimin në shtator të vitit 2019, me përfshirjen e Shteteve Anëtare, Presidencën e Këshillit të BE-së dhe Komisionin Evropian, rezultoi në një Deklaratë të Përbashkët Marrëveshjeje të lidhur nga Franca, Gjermania, Italia dhe Malta për një procedurë të strukturuar emergjence për të menaxhuar zbarkimet dhe marrëveshjet e rivendosjeve. Komisioni Evropian prezantoi një proces për zhvillimin e Procedurave Standarde Operacionale bazuar në këtë deklaratë, që solli një mirëkuptim të përbashkët mes Shteteve Anëtare dhe që po aplikohet në mënyrë operacionale.

Rivendosja zuri një vend të rëndësishëm në axhendën e politikave në lidhje me azilin gjatë vitit 2019. Është një komponent integral i përpjekjeve kolektive të BE-së për t'u ofruar mbrojtje atyre që kanë nevojë për të duke transferuar refugjatët nga një vend azili në një shtet tjetër që ka rënë dakord t'u japë atyre një vendosje të përhershme. Skema Evropiane e Rivendosjeve u prezantua në korrik të vitit 2015 dhe, deri në dhjetor të vitit 2019, dy programe të suksesshme rivendosjeje kanë asistuar më shumë se 65 000 persona.

Gjatë vitit 2019, BE-ja ka vazhduar bashkëpunimin e vet me partnerët e jashtëm për të menaxhuar presionin e migracionit nëpërmjet një përjasjeje gjithëpërfshirëse të themeluar në multilateralizëm. Qëllimet e aktiviteteve të implementuara në dimensionin e jashtëm të politikave të migracionit të BE-së përfshinin parandalimin e migracionit të parregullt, rritjen e bashkëpunimit me vendet e treta rreth kthimeve dhe ripranimeve, adresimin e shkaqeve bazë të migracionit duke përmirësuar mundësitë në vendet e origjinës dhe rritjen e investimeve në vendet partnere, ashtu si edhe sigurimin e rrugëve ligjore drejt BE-së për ata që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Në rolin e vet për të siguruar interpretimin dhe aplikimin e harmonizuar të ligjit të BE-së, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE) dha 12 gjykime gjatë vitit 2019 në lidhje me vendimet paraprake rreth interpretimit të CEAS-së. Për shembull, Gjykata vendosi për:

-  Zbatueshmërinë e Direktivës së Procedurave të Azilit, e ndryshuar, në lidhje me mbrojtjen ekzistuese ndërkombëtare në Shtetet Anëtare dhe rolin e institucioneve gjyqësore në kthimin e vendimeve të shkallës së parë;
-  Revokimin e mbrojtjes ndërkombëtare dhe vlefshmërisë së dispozitave të caktuara në Direktivën e Kualifikimeve, të ndryshuar;
-  Tërheqjen e kushteve të pritjes materiale si një formë sanksioni, nën dritën e Direktivës së Kushteve të Pritjes, Neni 20(4), të ndryshuar; dhe
-  Vlerësimin e personave nën ngarkim që konsiderohen anëtarë të rrethit të zgjeruar familjar (jo anëtarë të rrethit të ngushtë familjar) dhe aspektet procedurale të procedurës së bashkimit familjar.

Gjykata gjithashtu interpretoi konceptet kyçe dhe aspektet teknike të sistemit të Dublinit nën dritën e [Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian](#) dhe qartësoi çështjet paraprake si rezultat i tërheqjes së Mbretërisë së Bashkuar nga BE-ja (Brexit).



Burimi: EASO.

Gjatë vitit 2019, asistenca operacionale e EASO-s arriti nivele të paprecedenta në koordinimin e dislokimit të mbi 900 personave (duke përfshirë stafin e EASO-s, ekspertët nga vendet BE+, punonjësit e përkohshëm të agjencive, përkthyesit, ndërmjetësuesit kulturalë dhe personelin e sigurisë) në katër Shtetet Anëtare (Qipro, Greqi, Itali dhe Maltë). Afërsisht 40% e buxhetit vjetor të agjencisë u shpenzua për mbështetje operacionale gjatë vitit 2019.

Në fushën e mbështetjes për vendet e treta, gjatë vitit 2019 EASO-ja zhvilloi aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve në vendet e Ballkanit Perëndimor, Turqisë dhe vendet e rajonit të Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut (LMAV).

### 3. Të dhënat mbi Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit

Gjatë vitit 2019, në vendet BE+ u depozituan pothuajse 740 000 aplikime për mbrojtje ndërkombëtare, një rritje prej 11% krahasuar me vitin 2018. Kjo ishte hera e parë që prej krizës së migracionit të vitit 2015 që numri i aplikuesve filloi të rritej, pjesërisht për shkak të një rritjeje të lartë në aplikimet nga shtetasit nga Venezuela dhe vendet e tjera të Amerikës Latine. Në fakt, vendet kryesore pritëse, si Franca, Greqia dhe Spanja, pritën më shumë aplikues gjatë vitit 2019 sesa gjatë krizës së migracionit.


Aplikimet vazhduan të përqendroheshin në një numër të vogël Shtetesh Anëtare. Gjatë vitit 2019, Franca, Gjermania dhe Spanja morën më shumë se gjysmën e të gjitha aplikimeve në vendet BE+, të ndjekura në distancë nga Greqia. Në kontrast me këtë, Italia mori shumë më pak aplikime për vitin e dytë radhazi, shoqëruar me një migracion të parregullt të reduktuar shumë përgjatë itinerarit të Mesdheut Qendror. Duke i kthyer shifrat nga absolute në relative, bazuar në llogaritjet e EASO-s, Qiproja, Greqia dhe Malta morën shumicën e aplikimeve për mbrojtje kombëtare krahasuar me madhësinë e popullatave të tyre.

Tri vende origjine përbënin një të katërtën e të gjitha aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare në vendet BE+ gjatë vitit 2019. Në shifra absolute, aplikuesit nga Siria depozituan rreth 80 000 aplikime, të ndjekur nga Afganistani rreth 61 000) dhe Venezuela (rreth 46 000). Shpesh gjuha, lidhjet kulturore ose afërsia gjeografike mund të luajnë një rol në vendin ku depozitohet aplikimi. Kjo është tipike për amerikano-latinët (venezuelasit dhe kolumbianët, por edhe shtetasit e Guatemalës, Hondurasit dhe Nikaraguas) të cilët i depozitojnë aplikimet e tyre kryesisht në Spanjë. Udhëtimi pa viza mund të luajë gjithashtu një rol në vendin ku depozitohet aplikimi. Një tendencë e re e konsiderueshme gjatë vitit 2019 ishte rritja e numrit të aplikimeve të depozituara nga shtetasit e vendeve që nuk kanë nevojë për viza për të hyrë në zonën Schengen, që përbënin më shumë se një të katërtën e të gjitha aplikimeve (rreth 188 500).



Rritje në aplikimet e depozituara në vendet BE+ gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin 2018

Figura 1. Numri i aplikimeve nga vendet kryesore pritëse në Evropë, 2018-2019



Burimi: Eurostat.

Gjatë vitit 2019, vendet BE+ dhanë rreth 585 000 vendime rreth aplikimeve të shkallës së parë. Kjo tregoi një vazhdimësi në tendencën në rënie në numrin e vendimeve të dhëna për aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare që prej vitit 2016. Pesë vende përbënin tri të katërtat e të gjitha vendimeve të marra mbi mbrojtjen ndërkombëtare: Franca, Gjermania, Greqia, Italia dhe Spanja. Shumica e vendimeve të shkallës së parë u dhanë për shtetasit e Afganistanit, Sirisë dhe Venezuelës, që përbënin një të katërtën e të gjitha vendimeve në vendet BE+ gjatë vitit 2019. Aplikuesit nga Venezuela, Kolumbia, Salvadori, Palestina, Tunizia, Maroku dhe Jemeni morën shumë më tepër vendime gjatë vitit 2019 krahasuar me një vit më parë.


Dy të pestat e të gjitha vendimeve të shkallës së parë ishin pozitive, pra dhanë statusin e refugjatit (që përbënin më shumë se gjysmën e të gjitha vendimeve pozitive), mbrojtjen e përkohshme ose mbrojtjen humanitare (të dhënë në pothuajse pjesë të barabarta).

Një zhvillim i konsiderueshëm gjatë vitit 2019 ishte numri i vendimeve pozitive të dhëna për aplikuesit nga Venezuela. Norma e pranimit për venezuelasit ishte 96% gjatë vitit 2019, krahasuar me vetëm 29% gjatë vitit 2018. Kombësitë e tjera me norma të larta pranimit përfshinin: sirianët (86%), eritreasit (85%) dhe jemenasit (82%). Në kontrast me këtë, aplikuesit nga Maqedonia e Veriut dhe Moldavia morën pjesën më të ulët të vendimeve pozitive, 1% secila.

Numri i aplikimeve që u tërhoqën në vitin 2019 u rrit me 20% duke arritur në afërsisht 69 500. Aplikimet e tërhequra, veçanërisht ato të padyshimta, mund të shërbejnë si tregues të largimit dhe të fillimit të lëvizjeve dytësore drejt vendeve të tjera BE+. Të dhënat paraprake të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe Përgatitjes (EPS) të EASO-s sugjerojnë se pothuajse tri të katërtat e të gjitha aplikimeve të tërhequra në shkallën e parë gjatë vitit 2019 ishin të padyshimta. Në përputhje me këtë interpretim, shumica e tërheqjeve u zhvilluan në Shtetet Anëtare të vijës së frontit, si p.sh. Greqia dhe Italia, që së bashku kishin më shumë se dy të tretat e të gjitha tërheqjeve.


Në fund të vitit 2019, pothuajse 912 000 aplikime për mbrojtje ndërkombëtare vazhdonin të ishin në pritje të një vendimi në vendet BE+, duke përfaqësuar më shumë se 1% më shumë se në vitin 2018. Në total, vonesat nga akumulimet e çështjeve ishin sërish shumë më të mëdha se nivelet para krizës, që ilustron presionin e shtuar nën të cilin funksionojnë aktualisht sistemet e azilit të BE-së. Gjermania vazhdoi të kishte numrin më të lartë të çështjeve të hapura, por në kontrast me shumë vende BE+, kishte një reduktim në numrin e përgjithshëm mes fundit të vitit 2018 dhe vitit 2019. Stoku i çështjeve në pritje ishte i konsiderueshëm dhe në rritje në Belgjikë, Greqi, Francë, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Llogaritjet e bazuara në të dhënat e Eurostat-it dhe EASO-s theksojnë se më shumë se gjysma e çështjeve që janë në pritje të vendimit, ose mbi 540 000, ishin në pritje në shkallën e parë. Në të gjitha vendet me rritje të konsiderueshme në numrin e rasteve në pritje, tendenca drejtohej kryesisht nga fakti se depozitoheshin më shumë aplikime, dhe për këtë arsye kishte vonesa nga akumulimet në shkallën e parë.

### Aplikimet në pritje për mbrojtje ndërkombëtare në vendet BE+ në fund të vitit, 2014-2019



Burimi: EASO dhe Eurostat.

20 vendet kryesore të originës së aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare në vendet BE+, 2019



Rritje në numrin e aplikimeve të tërhequra gjatë vitit 2019



Rritje e aplikimeve nga vendet e përjashtuara nga kërkesat e vizave gjatë vitit 2019

**1/4**

e të gjitha aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare ishin nga **3 vende**:

**Siria, Afganistani dhe Venezuela**



## 4. Procedura e Dublinit



Rregullorja e Dublinit III synon të përcaktojë një metodë të qartë dhe të realizueshme për të përcaktuar se cili Shtet Anëtar është përgjegjës për ekzaminimin e secilit aplikim për mbrojtje ndërkombëtare. Objektivi i saj është të garantojë që aplikuesit të kenë qasje efektive në procedurat për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare dhe që ekzaminimi i një aplikimi të kryhet nga një Shtet Anëtar i vetëm dhe i përcaktuar qartë. Nëse, pas ekzaminimit të kritereve të Dublinit, rezulton se një tjetër Shtet Anëtar është përgjegjës për përpunimin e një aplikimi, sistemi i Dublinit parashikon mundësinë e transferimit fizik të aplikuesit drejt Shtetit Anëtar të përcaktuar si përgjegjës.

Bazuar në të dhënat e shkëmbyera nëpërmjet EPS-së të EASO-s, kishte një rritje 3% në numrin e vendimeve në kërkesat e Dublinit në proces gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018. Kjo përbën rreth 145 000 vendime në total, duke përfshirë si kërkesat, ashtu dhe kërkesat për riekzaminim. Raporti i vendimeve të Dublinit për aplikimet e azilit të depozituara ishte 20% gjatë vitit 2019, që mund të nënkuptojë se një numër i lartë aplikuesish për mbrojtje ndërkombëtare vazhduan lëvizjet dytësore mes vendeve BE+.

Si në vitet e mëparshme, Gjermania dhe Franca morën shumicën e vendimeve në përgjigje të kërkesave të Dublinit, ku secila përbënte një çikë më pak se një të tretën e totalit të vendimeve. Vendi kryesor që iu përgjigj kërkesave vazhdoi të ishte Italia, e ndjekur nga Gjermania, Spanja, Greqia dhe Franca. Norma e përgjithshme e pranimit për vendimet mbi kërkesat e Dublinit, e matur sipas raportit të vendimeve që pranojnë përgjegjësinë nga të gjitha vendimet e dhëna, ra për vitin e dytë radhazi gjatë vitit 2019, në 62%.

Evokimi i Nenit 17(1) të Rregullores së Dublinit, e njohur si klauzola e lirisë së veprimit ose klauzola e sovranitetit, u ul në mënyrë të konsiderueshme gjatë vitit 2019 në 6900 raste. Sipas kësaj klauzole, një Shtet Anëtar mund të vendosë ta ekzaminojë një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, edhe nëse nuk është përgjegjësia e tij sipas kritereve në Rregulloren e Dublinit III.

Vendet BE+ implementuan rreth 27 200 transferime, një ulje 3% krahasuar me vitin 2018, që është në përputhje me uljen e vogël në kërkesat e pranuar. Rreth 30% e transferimeve u implementuan nga Gjermania, e ndjekur nga Franca (20%), Holanda (11%), Greqia (9%), Polonia dhe Austria (5% secila).

Një numër relativisht i vogël zhvillimesh legislative dhe të politikave në lidhje me procedurën e Dublinit ndodhën gjatë vitit 2019, me përjashtim të vendeve që njohën një rritje të konsiderueshme në numrin e aplikuesve për azil sipas procedurave të Dublinit, si Belgjika dhe Holanda. Shumica e këtyre zhvillimeve kishin lidhje me ndryshimet institucionale dhe organizative për të reduktuar vonesat nga akumulimet dhe për të rritur efikasitetin brenda sistemit të Dublinit.

Gjatë vitit 2019,  
vendet BE+  
implementuan rreth  
27 200 transferime,  
që ishin 3% më pak  
se në vitin 2018



Në pritje të reformës të ardhshme të sistemit të Dublinit, gjykatat evropiane dhe kombëtare vazhduan të interpretojnë disa prej rregulloreve dhe direktivave, duke dhënë udhëzime bazuar në rastet individuale. Sipas Rregullores së Dublinit III, Neni 3(2), Shtetet Anëtare do të jenë përgjegjëse për ekzaminimin e një aplikimi, nëse ka arsye të konsiderueshme për të besuar se ka mangësi sistematike në procesin e azilit dhe në kushtet e pritjes në Shtetin Anëtar që do të përcaktohej si përgjegjës bazuar në kriteret e Dublinit. Gjatë vitit 2019, transferimet drejt vendeve të tjera nuk u pezulluan në mënyrë sistematike nga ndonjë Shtet Anëtar. Megjithatë, ka shumë ndryshime në praktikën në Shtetet Anëtare gjatë pezullimit të transferimeve drejt Shteteve Anëtare specifike të Dublinit.

Organizatat e shoqërisë civile shprehën shqetësime në lidhje me hendeqet në metodologji dhe në funksionimin e sistemit të Dublinit në praktikë. Të drejtat e aplikuesve duhet të mbrohen, duke parandaluar njëkohësisht lëvizjet dytësore në Shtetet e tjera Anëtare. Duhet të ketë stimuj pozitivë si për aplikuesit, ashtu edhe për vendet, për të ndjekur procedurat e sistemit, në vend të kufizimeve në rritje të Shteteve Anëtare.

## 5. Të miturit e pashoqëruar dhe aplikuesit vulnerabël



Legjislacioni i BE-së për azilin përfshin dispozita mbi identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes për aplikuesit që kanë nevojë për garanci të veçanta procedurale. Në përgjithësi, identifikimi efektiv dhe i shpejtë i aplikuesve vulnerabël mbetet sfidë, veçanërisht në lidhje me vulnerabilitetet që nuk duken, si p.sh. pasojat psikologjike të torturës ose traumës.

Mes aplikuesve vulnerabël, një prej grupeve kyçe janë të miturit e pashoqëruar që kërkojnë mbrojtje pa kujdesin e një të rrituri përgjegjës. Gjatë vitit 2019, në vendet BE+ u depozituan pothuajse 17 700 aplikime për mbrojtje ndërkombëtare nga minorenët e pashoqëruar, një ulje prej 13% krahasuar me vitin 2018. Aplikimet nga të miturit e pashoqëruar përbënin 2% të numrit total të aplikimeve.

Si në vitet e mëparshme, gjatë vitit 2019 u prezantuan shumë nisma për të përmirësuar situatën e aplikuesve vulnerabël. Disa vende prezantuan masa për identifikimin e hershëm dhe ofrimin e mbrojtjeve procedurale. U morën gjithashtu hapa për të përmirësuar ose rregulluar metodologjitë e vlerësimit të moshës, ndërsa shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare vazhduan të vërejnë hendeqe dhe mangësi në proces. U prezantuan ndryshime legislative dhe në politika për përfaqësimin ligjor për të përshtatur emërimin e kujdestarëve dhe për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të sistemit të kujdestarisë.

Organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile komentuan rreth përmirësimit të procesit të emërimit, objektivit të detyrave të kujdestarëve, komunikimit mes përfaqësuesit dhe fëmijët, si edhe ngarkesës së punës së kujdestarit dhe trajnimit në përgjithësi. Për të dhënë informacione më të qarta, disa vende BE+ miratuan materiale komunikimi mbi azilin dhe pritjen të përshtatura për nevojat specifike të të miturve. Megjithatë, grupe të tjera vulnerabël kryesisht nuk u mbuluan nga këto nisma.


Në procedurat e shkallës së parë, vetëm pak nisma u raportuan drejt përmirësimit të procedurave për të miturit dhe për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës. Një fokus disi më i lartë duket se i është kushtuar përmirësimit të procedurave për vajzat që rrezikohen nga gjymtimi gjenital i femrës (FGM), viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe aplikuesit lesbikë, homoseksualë, transgjinorë dhe interseksualë (LGBTI).

Në lidhje me kushtet e pritjes, përpjekjet nga vendet BE+ në vitin 2019 u fokusuan në përshtatjen e kapaciteteve në ambiente dhe rritjen e cilësisë së kushteve të pritjes për minorenët e pashoqëruar dhe aplikuesit vulnerabël, përmirësimin e ambienteve të specializuara të pritjes dhe trajnimitin e personelit që menaxhon aplikuesit vulnerabël, veçanërisht të miturit e pashoqëruar. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile shprehën shqetësime rreth kushteve të këqija të pritjes për personat vulnerabël në një numër vendesh. Gjithashtu, ndalimi i aplikuesve vulnerabël, veçanërisht i fëmijëve, vazhdoi të ngrinte pikëpyetje themelore në shumë vende BE+, dhe u bë tema e një numri vendimesh në gjykatat evropiane dhe kombëtare.

Kushtet e këqija të pritjes dhe ndalimit të azilkërkuësve të mitur të pashoqëruar mbetën shqetësim në një numër vendesh

Situata e tranzicionit të të miturve të pashoqëruar ishte shqetësim si për autoritetet kombëtare, ashtu edhe për organizatat e shoqërisë civile nëpër Evropë. Për arsye diverse dhe komplekse, duke përfshirë kohëzgjatjen e procesit të azilit dhe dispozitave të Rregullores së Dublinit III, fëmijët e pashoqëruar shpesh provonin të mbeteshin të paidentifikuar dhe të kalonin tranzit përmes një ose disa vendeve për të mbërritur në një Shtet Anëtar të caktuar.

## Të miturit e pashoqëruar në kërkim të mbrojtjes ndërkombëtare, 2019



## 6. Pikat kryesore në nivel kombëtar

U vu re një numër zhvillimesh në fushat e tematikës kryesore të CEAS-së të implementuara në nivel kombëtar gjatë vitit 2019.



### Qasja në procedurë

Shumica e vendeve BE+ u fokusuan në implementimin dhe përmirësimin e procedurave kombëtare të azilit sipas ndryshimeve në legjislacion, politika dhe praktikë të prezantuar gjatë viteve të fundit. Këto ndryshime nga vitet e mëparshme përfshinin krijimin e qendrave të mbërritjes, prezantimin e teknologjive të reja për të mbështetur identifikimin e aplikuesit dhe paraqitjen që në fazat e hershme të procedurës të detyrës së aplikuesit për të bashkëpunuar dhe për të siguruar gjithë dokumentacionin dhe informacionet e rëndësishme.

Debati publik kishte si bosht çështjet themelore ligjore, politike dhe shoqërore në lidhje me kufijtë e jashtëm të BE-së, në veçanti në lidhje me operacionet e kërkim-shpëtimit në Detin Mesdhe, zbarkimin dhe rivendosjen. Komisioni Evropian njohu nevojën për një zgjidhje të përkohshme më të strukturuar dhe filloi të koordinojë veprimin për të siguruar zbarkimin e sigurt dhe rivendosjen e shpejtë të emigrantëve të shpëtuar, me plane për të zhvilluar procedura standarde operimi.

Si masë për të kontrolluar më rreptësisht kufijtë tokësorë, një numër Shtetesh Anëtare kanë rifutur kontrollet në kufijtë e brendshëm Schengen. Megjithatë, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile vazhduan të raportojnë kundërshtime në kufijtë tokësorë dhe detarë, heqjen pa identifikimin e duhur dhe periudha të gjata pritjeje për regjistrimin dhe depozitimin e aplikimit.

### Qasja në informacion

Personat që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare kanë nevojë për informacion në lidhje me situatën e tyre që të jenë në gjendje të komunikojnë plotësisht nevojat e tyre të mbrojtjes dhe rrethanat personale dhe t'i vlerësojnë ato plotësisht dhe në mënyrë të drejtë.

Gjatë vitit 2019, vendet BE+ vazhduan të zgjerojnë metodat e dhënies së informacionit si për azilkërkuesit, ashtu edhe për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare, me raste nëpërmjet projekteve të përbashkëta me OJQ-të ose organizatat ndërkombëtare. Informacioni jepej kryesisht në gjuhë të ndryshme nëpërmjet platformave informuese, fletëpalosjeve, broshurave, videoklipeve ose aplikacioneve për smartfonë. Informacioni që jepet aktualisht nga vendet përfshin jo vetëm aspektet e procedurës së azilit, por edhe situatat e jetës së përditshme në vendin pritës, integrimin, kthimin, rivendosjen dhe fushatat ndërgjegjësuese. Disa materiale janë përshtatur në veçanti për aplikuesit vulnerabël.



## Asistenca dhe përfaqësimi ligjor

Gjatë vitit 2019, vendet BE+ prezantuan ndryshime legislative për të ofruar dhe zgjeruar këshillimin ligjor falas për të gjithë aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare nëpërmjet programeve të ndryshme kombëtare. Vendet BE+ implementuan projekte të reja në lidhje me asistencën ligjore, si edhe vazhduan ose zgjeruan ato të mëparshmet. Shqetësimet e shprehura nga organizatat e shoqërisë civile përfshinin kompensim të ulët financiar për asistencë ligjore, mungesën e ambienteve të përshtatshme për të kryer intervistat përgatitore dhe private, mungesën e qasjes në asistencë ligjore për hartimin e apelimeve kundër vendimeve të shkallës së parë ose mungesën e ndihmës ligjore që ofrohet nga qeveria për azilkërkuesit në qendrat e ndalimit që rezultuan në ndihmë ligjore pa pagesë nga OJQ-të.

## Përkthimi

Duhet të ketë shërbime përkthimi për t'u siguruar që shkëmbimi i informacionit mes aplikuesit dhe autoritetit të azilit të jetë i saktë dhe të kuptohet nga të dyja palët.

Gjatë vitit 2019, ndryshimet në këtë fushë përfshinin zgjerimin e buxheteve të përcaktuara për ofrimin e përkthimit, rritjen e numrit të përkthyesve, ofrimin e më shumë informacioni në më shumë gjuhë nëpërmjet një shumëllojshmërie mjetesesh, prezantimin e teknologjive moderne për të mbështetur përkthimin dhe përshtatjen e praktikave sipas nevojave aktuale. Sfidat me të cilat u përballën vendet BE+ përfshinin një mungesë personeli në faza të caktuara të procedurës së azilit dhe kualifikime të pamjaftueshme të përkthyesve të përfshirë në proces.

## Procedurat speciale

Gjatë ekzaminimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare në shkallën e parë, Shtetet Anëtare mund të përdorin procedura speciale, si p.sh. procedurat e përshpejtuara ose procedurat me prioritet, duke iu përmbajtur njëkohësisht parimeve bazë dhe garancive të përcaktuara në legjislacionin evropian të azilit.

Gjatë vitit 2019, Italia dhe Zvicra implementuan procedura të reja për aplikimet e bëra në kufi. Gjithashtu, një numër vendesh BE+ bënë ndryshime në listën e tyre të vendeve të sigurta të origjinës, ndërsa të tjera, si Italia dhe Qiproja, i prezantuan për herë të parë këto lista. Një procedurë e përshpejtuar u përdor në Qipro për herë të parë dhe prej marsit 2019, Zvicra aplikoi procedurën e përshpejtuar me synimin e arritjes së një vendimi në shumicën e rasteve brenda 140 ditësh.

Vendet BE+ gjithashtu u fokusuan në përcaktimin e kritereve për aplikimet vijuese për mbrojtje ndërkombëtare për të parandaluar keqpërdorimin e sistemit të azilit duke depozituar aplikime të përsëritura pa meritë.

Brenda kuadrit të një procedure të rregullt ose speciale, disa vende i dhanë prioritet vlerësimit të aplikimeve nga grupe specifike aplikuesish në mënyrë që të përpunoheshin përpara aplikimeve të tjera. Për shembull, për shkak të shtimit të lartë të aplikuesve nga Venezuela dhe vendet e tjera të Amerikës Latine, Spanja u dha prioritet çështjeve të tyre për të përshpejtuar vendimet.





### Procedurat në shkallën e parë

Për të përmirësuar efikasitetin e përpunimit të aplikimeve dhe për të reduktuar kohën e përpunimit në shkallë të parë, vendet BE+ implementuan ndryshime legislative, ndryshime institucionale, masa praktike dhe metoda të reja pune. Sfidat e ngritura nga organizatat e shoqërisë civile sërish përfshinin procedura tejet të gjata të shkallës së parë, që shpesh i tejkalonin limitet ligjore.



### Pritja e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare

Vendet BE+ u fokusuan në implementimin e ndryshimeve të konsiderueshme që u prezantuan në vitin 2018 në organizimin e procedurave kombëtare të pritjes. Një numër vendesh përshtatën kuadrin e tyre institucional për të lehtësuar procesin e implementimit dhe të tjera vazhduan përpjekjet për të zgjeruar akomodimin për numrin në rritje të aplikuesve. Disa vende ulën kapacitetin e pritjes.

Për të përmirësuar kushtet e pritjes, një numër vendesh krijuan direktiva, implementuan monitorimin, rritën fondet dhe ndërmorën ushtrime simulimi.

Disa nisma gjatë vitit synuan ndryshimin e kohëzgjatjes, objektivin dhe kushtet e të drejtave për kushtet e pritjes materiale për një numër grupesh aplikuesish. U ndërmorën gjithashtu nisma për të adresuar sjelljen shqetësuese dhe për të garantuar sigurinë në ambientet e pritjes. Gjykatat ishin në veçanti aktive në adresimin e mangësive në sistemet kombëtare të pritjes, duke përfshirë rishikimin e standardeve të pritjes përtej kufijve kombëtarë në kontekstin e transferimeve të Dublinit.

Megjithatë, UNHCR-ja dhe organizatat e shoqërisë civile identifikuan mangësitë në qasjen në strehim, kujdes shëndetësor dhe arsim për fëmijët dhe të rinjtë.



### Ndalimi

Vendet e BE+ prezantuan legjislacione të reja ose amendamente për të përcaktuar më tej ose përpunuar arsyet e ndalimit dhe alternativat ndaj ndalimit në kontekstin e azilit dhe procedurave të kthimit. Legjislacioni adresoi çështje me aplikuesit që nuk bashkëpunojnë, aplikuesit që përbëjnë kërcënim ose rrezik për sigurinë kombëtare të vendit pritës, rastet e sjelljes shqetësuese ose transgresive, si dhe rrezikun e largimit. Gjithashtu, ndalimi u lidh më tej me përsheptimin e procedurave të azilit dhe zbatimin e kthimeve.

Në disa vende u vërejt gjithashtu një përpjekje e zhvendosjes së politikave drejt identifikimit të alternativave ndaj ndalimit. Prej vitit 2018, organizatat e shoqërisë civile shprehën shqetësime në një numër vendesh me implementimin e pasaktë të legjislacionit të azilit të BE-së në lidhje me ndalimin e azilkërkuesve dhe mbrojtjet brenda procedurës së ndalimit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) mbeti aktive në rishikimin e praktikave dhe kushteve të ndalimit, duke qartësuar njëkohësisht të drejtat e aplikuesve.

## Procedurat në shkallën e dytë

Fushat kryesore të zhvillimeve në vitin 2019 përfshinin efektin pezullues të apelimeve kundër vendimeve të shkallës së parë, ndryshimet në lidhje me limitet kohore për apelimet, ristrukturimin institucional për të përcaktuar autoritetin përgjegjës për apelimet, prezantimin e mbrojtjeve që u jepen aplikuesve, si dhe masat për të përmirësuar efikasitetin e procedurave të shkallës së dytë, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të reja.

Në përgjithësi, vonesat nga akumulimet e çështjeve të apelimeve dhe kohëzgjatja e procedimeve mbetën dy aspekte të dukshme për procedurat në shkallën e dytë gjatë vitit 2019, ku një numër vendesh BE+ morën masa për të reduktuar numrin e apelimeve në pritje. Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e vendimeve ishin në pritje në shkallën e dytë, gjykatat dhe tribunalët kishin mundësinë nëpërmjet vendimeve të tyre t'i jepnin formë më tej aplikimit praktik të procedurës së azilit dhe fushave të tjera të CEAS-së.

## Informacioni nga vendi i origjinës

Duke u përballur me një fluks të lartë aplikuesish për mbrojtje ndërkombëtare nga vende të ndryshme origjine gjatë viteve të fundit, vendet BE+ kanë marrë hapa konkretë për të përmirësuar gamën dhe cilësinë e informacionit të prodhuar rreth informacionit nga vendi i origjinës.

Gjatë vitit 2019, u forcua bashkëpunimi dhe ndarja e përvojës mes vendeve BE+, e koordinuar shpesh nga EASO-ja nëpërmjet rrjeteve të specializuara. Gjithashtu, shumë vende investuan në trajnimin e personelit rreth metodologjisë së kërkimeve të informacioneve nga vendi i origjinës, ndërkohë që misionet faktmbledhëse vazhduan të ishin mjeti kryesor për grumbullimin e informacionit dhe grumbullimin e njohurive të detajuara rreth situatës në vende të caktuara të origjinës ose të tranzitit.

Sfidat në fushën e informacionit nga vendi i origjinës përfshinin mungesën e burimeve në gjuhët kombëtare, mungesën e informacionit të detajuar mbi disa vende origjine ose profile aplikuesish, si dhe vështirësinë në qasjen e informacionit të përditësuar në vendet në të cilat situata ndryshon me shpejtësi.

## Mungesa e nënshtetësisë

Personat pa nënshtetësi dhe përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare janë dy kategori të ndryshme në ligjin ndërkombëtar, por një person mund të jetë përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare dhe pa nënshtetësi. Në kontekstin e azilit, mungesa e nënshtetësisë mund të ndikojë në procesin e përcaktimit për një aplikim për mbrojtje, si edhe mbrojtjet procedurale.

Një numër vendesh BE+ morën hapa për adresimin e mungesës së nënshtetësisë gjatë vitit 2019, duke përfshirë anëtarësimin në instrumentet përkatëse ligjore ndërkombëtare, krijimin e procedurave të dedikuara për përcaktimin e mungesës së nënshtetësisë, ofrimin e qasjes në nënshtetësi në lindje, lehtësimin e qasjes në natyralizim, përforsimin e përmbajtjes së mbrojtjes për personat pa nënshtetësi, përshpejtimin e procesit të përcaktimit të mungesës së nënshtetësisë dhe sigurimin e mbledhjes së të dhënave të regjistrimit për personat pa nënshtetësi. Megjithatë, duket se vazhdojnë sfidat me të cilat përballen personat pa nënshtetësi në faza të ndryshme të procedurës së azilit, nga qasja në ndalim dhe kthim.





### Përmbajtja e mbrojtjes

Personat të cilëve u është dhënë një formë mbrojtjeje ndërkombëtare në një vend BE+, mund të përfitojnë nga një gamë të drejtash dhe përfitimesh. Zhvillimet në legjislacion, politika dhe praktikë rreth përmbajtjes së mbrojtjes ishin të ndryshme nëpër vendet BE+ gjatë vitit 2019, dhe prandaj, tendencat e përgjithshme ishin të vështira për t'u identifikuar.

Nismat zakonisht adresonin nevojat e veçanta në secilin vend dhe ishin të përshtatura për profilet specifike të përfituesve në ato vende. Shumë zhvillime gjatë vitit kishin lidhje me strategjitë kombëtare të integritimit në përgjithësi dhe me rishikimin, pushimin dhe revokimin e statusit të mbrojtjes.

Një numër sfidash legjislative adresuan objektivin e së drejtës dhe kritereve për bashkim familjar, ndërsa disa vende zhvilluan masa gjithëpërfshirëse për të rritur pjesëmarrjen e shtetasve të vendeve të treta në tregun e punës.

### Kthimi i ish-aplikuesve

Vendet BE+ vazhduan përpjekjet e tyre gjatë vitit 2019 për të identifikuar zgjidhje për kthimin efektiv të personave pa të drejtë qëndrimi në BE, duke përfshirë ish-aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare. Në *Analizën vjetore të rreziqeve për vitin 2020*, Frontex tregoi se numri i vendimeve për kthim të dhëna gjatë vitit 2019 ishte shumë më i lartë se numri i kthimeve efektive që raportohet se janë kryer gjatë të njëjtit vit.

Në këtë kontekst, një numër amendamentesh legjislative të prezantuara nga vendet BE+ synonte të lehtësonte kthimin nëpërmjet detyrimeve shtesë për të bashkëpunuar, heqjes së efektit pezullues të apelimeve kundër vendimeve të kthimit, rritjes së mundësive për ndalim dhe përshpejtimin të procedurave të kthimit.

U prezantuan gjithashtu edhe masa praktike, duke përfshirë udhëzime të reja dhe masa teknike, për të adresuar sfidat specifike, të tilla si abuzimi me mbështetjen financiare për t'u kthyer dhe rreziku i largimit pas dhënies së një vendimi negativ. Gjithashtu, vendet BE+ prezantuan dhe implementuan projekte që synonin përforcimin e cilësisë së procesit të kthimit duke respektuar njëkohësisht të drejtat themelore. Përpjekjet vazhduan gjithashtu të ofrojnë kanale për kthimin vullnetar të asistuar të ish-aplikuesve.

### Programet e rivendosjes dhe të pranimit humanitar


Gjatë vitit 2019, vendet BE+ bënë progres drejt arritjes së objektivit të rivendosjes së 50 000 migrantëve, parashikuar në rekomandimet e Komisionit Evropian nga viti 2017 sipas [Skemës së dytë të Rivendosjes së BE-së](#).

Gjatë vitit 2019, në Evropë mbërritën rreth 30 700 persona nëpërmjet rivendosjes, 8% më shumë se në vitin 2018. Siç ka ndodhur për tri vjet, sirianët përbënin rreth dy të tretat e personave të rivendosur. Duke iu përgjigjur thirrjes së Komisionit Evropian, vendet BE+ u zotuan për 29 500 vende rivendosjeje më shumë për vitin 2020.





## Hapat kyçë të procedurës së azilit



## Konkluzionet

Gjatë vitit 2019, numri i aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare në Evropë u rrit për herë të parë që prej vitit 2015. Me këtë sfond, vendet BE+ vazhduan përpjekjet e tyre për të kalibruar më tej sistemet e tyre të azilit dhe për të përforcuar zgjidhjet për mbrojtje ndërkombëtare, duke ndërtuar mbi nismat e prezantuara gjatë viteve të mëparshme.

Siç përcaktohet në raport, zhvillimet kryesore përfshinin:

- Vonesat nga akumulimet e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare që vazhdojnë të presin për një vendim, mbeten shumë më të larta krahasuar me nivelet para vitit 2015, duke ilustruar trysninë e shtuar nën të cilën vazhdojnë të operojnë sistemet e azilit dhe të pritjes në vendet BE+.
- Lëvizjet dytësore të aplikuesve kanë tërhequr gjithnjë e më shumë vëmendje mes vendeve BE+ dhe u shtuan në debatet rreth funksionimit aktual të procedurës së Dublinit.
- Vendet BE+ vazhduan të vendosin theksin mbi regjistrimin dhe mbledhjen e shpejtë të informacionit të detajuar nga aplikuesit në fazat e hershme të procedurës së azilit për të bërë dallim më të mirë mes personave që kanë nevojë për mbrojtje dhe atyre që do të kthehen. Kjo është plotësuar me masa për përforcimin e procedurave kufitare.
- U rritën përpjekjet mes vendeve BE+ për të mbështetur nevojat e aplikuesve me vulnerabilitete, nga identifikimi i hershëm dhe ofrimi i mbrojtjeve procedurale deri te përmirësimi i ambienteve të specializuara të pritjes dhe zhvillimi i materialeve me informacione të përshtatura në veçanti për të miturit e pashoqëruar.
- Me një numër çështjesh në pritje në shkallën e dytë, gjykatat dhe tribunalët vazhduan të luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e aplikimit praktik të dispozitave të legjislacionit evropian të azilit.
- Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme nga vendet BE+ për të identifikuar zgjidhjet për kthimin efektiv të personave pa të drejtë qëndrimi në BE, duke përfshirë ish-aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare, numri i kthimeve reale mbetet shumë më i ulët se vendimet e kthimit.
- Në mungesë të progresit të konsiderueshëm legjislativ drejt paketës së reformave të CEAS-së, u arrit një punë e konsiderueshme në implementimin e politikave dhe bashkëpunimin praktik mes vendeve BE+ në fushën e azilit.
- Çështjet themelore në lidhje me kufijtë e jashtëm të BE-së mbeten në plan të parë të debatit publik, veçanërisht në lidhje me operacionet e shpëtimit në Detin Mesdhe dhe zbakimin e sigurt dhe rivendosjen e migrantëve të shpëtuar. Rritja e flukseve të migrimit në itinerarin e Mesdheut Lindor shtoi trysninë ekzistuese mbi sistemet e azilit të Shteteve Anëtare në rajon. Për t'u ndihmuar Shteteve Anëtare të vijës së frontit përgjatë itinerareve të Mesdheut Qendror dhe Lindor, në vitin 2019 EASO-ja përmirësoi dhe, kur ishte nevoja, zgjeroi mbështetjen e vet operacionale për Qipron, Greqinë, Italinë dhe Maltën.

Tendencat e përmendura në *EASO - Raporti rreth Azilit, 2020* përcaktuan sfondin për vitin aktual. Gjithashtu, pandemia globale e COVID-19 do të luajë një rol kritik në dhënien formë të zhvillimeve të lidhura me azilin duke theksuar nevojën për përfaqje inovative drejt sigurimit të respektimit të plotë të të drejtës për azil. Me Paktin e Ri mbi Migrimin dhe Azilin i cili po hartohet aktualisht, mësimet e nxjerra nga pandemia e COVID-19 mund të jenë të çmuara në modernizimin dhe përmirësimin e procedurave të azilit mes vendeve BE+.



ISBN 978-92-9485-543-5

